

Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës, sipas Eurostat-it, ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.4 përqind në TM1 2024,** e ndikuar nga normat ende të larta të interesit. Projektionet e BQE-së sugjerojnë për rritje reale të BPV-së për vitin 2024 prej 0.9 përqind, dhe për vitin 2025 prej 1.4 përqind. Shkalla e inflacionit në TM1 2024 ka shënuar 2.6 përqind, një rënie e dukshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (8.0 përqind në TM1 2023). Projektionet e BQE-së sugjerojnë për një ngadalësim të inflacionit në 2.5 përqind në 2024, dhe tutje në 2.2 përqind në vitin 2025.
- **Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, aktiviteti ekonomik në Kosovë në TM1 2024 ka shënuar rritje të përshpejtuar prej 5.6 përqind, dinamikë kjo e ndikuar kryesisht nga kërkesa vendore.** Konsumi privat, investimet si dhe eksporti i shërbimeve kontribuuan pozitivisht në rritjen reale ekonomike, ndërsa ndikim negativ patën rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit të mallrave dhe shërbimeve. Parashikimet e BQK-së për vitin 2024 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të mbështetet nga rritja e të ardhurave reale të disponueshme, falë uljes së inflacionit, dhe rritjes së burimeve të financimit. **BQK parashikon rritje ekonomike prej 3.9 përqind për vitin 2024,** që pritet të mbështetet nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve, kundrejt ndikimit negativ të importit të mallrave dhe shërbimeve në BPV.
- **Inflacioni vazhdoi të ndjekë trend ngadalësimi në TM1 2024, me një normë mesatare prej 2.1 përqind.** Ngadalësimi ishte kryesisht rezultat i lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Rritje e ngadalësuar u evidentua në një pjesë të madhe të komponentëve në shportën e konsumit, kurse çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse të ngurta shënuan rritje. Inflacioni bazë stagnoi në 3.6 përqind në TM1 2024. Sipas projeksioneve të BQK-së, inflacioni pritet të vazhdojë trendin e ngadalësimit duke arritur në mesatare vjetore prej 2.5 përqind në vitin 2024.
- **Në TM1 2024, të hyrat primare buxhetore të Kosovës shënuan rritje prej 17.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, mbështetur nga aktiviteti ekonomik, formalizimi i ekonomisë dhe përmirësimi i përgjegjësisë fiskale. Shpenzimet buxhetore u rritën gjithashtu me 14.7 përqind, por të hyrat e shtuara siguruan një bilanc pozitiv për buxhetin. Borxhi publik u ul në 15.6 përqind të BPV-së, krahasuar me 18.1 përqind në TM1 2023.** Rritja e të hyrave dhe BPV-së nominale ishin faktorët kryesor që ndikuan në uljen e borxhit publik.
- **Llogaria rrjedhëse në TM1 2024 u karakterizua me rritje të deficitit prej 40.4 përqind, duke arritur vlerën prej 318.9 milionë euro (15.2 përqind e BPV-së).** Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në TM1 2024 kanë vazhduar të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Remitencat, si një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të konsumit, shënuan rritje prej 3.6 përqind dhe arritën vlerën prej 281.1 milionë euro, ndërsa investimet e huaja direkte shënuan rritje prej 13.2 përqind dhe arritën vlerën prej 214.7 milionë euro.
- **Spektori bankar** ndër vite ka siguruar nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit, dhe cilësi të lartë të aseteve - më konkretisht, nivel të ulët të kredive jo-performuese. **Aktiviteti kreditues** kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sektorit bankar, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar se viti paraprak, pasuar nga **investimet në letrat me vlerë** në ambient me norma të rritura të interesit. Dinamikat në politikën monetare të BQE-së kanë ndikuar pjesërisht edhe në normat e interesit të aplikuara nga bankat vendore, meqenëse sinjalet për ndërprerje të trendit rritës të normave të interesit nga BQE u reflektuan në rënien e normave të interesit në kredi dhe ndërprerje të trendit rritës së normës së interesit në depozita. Asetet e **sektorit pensional** shënuan rritje të lartë në mars 2024, pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë, si rezultat i kthimit pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme duke përfitur nga norma të larta të interesit dhe kontributeve në rritje nga pagë-marrësit në vend.
- **Spektori i sigurimeve** u karakterizua me rritje, por më të ngadalësuar për herë të parë në pesë vitet e fundit. Zgjerimi i sektorit buroi nga rritja e rezervave teknike, që janë rezultat i primeve të shkruara deri në mars 2024, si dhe kapitalit vetanak të siguruesëve.
- **Spektori mikrofinanciar** shënoi rritje të lartë të aktivitetit në, mbështetur kryesisht nga huamarrjet nga sektori i jashtëm për të financuar kreditimin dhe lizingjet. Sektori ka mbajtur nivel të ulët të kredive me probleme dhe ka realizuar nivel të lartë të profitabilitetit.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

Përmbajtja

Përmbledhje	i
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	3
3. Ekonomia e Kosovës	6
3.1. Rritja Ekonomike	6
3.2. Çmimet	7
3.3. Sektori Fiskal	9
3.4. Sektori i jashtëm	10
4. Sistemi financiar	13
4.1. Sektori bankar	14
4.2. Sektori pensional	14
4.3. Sektori i sigurimeve	23
4.4. Sektori mikrofinanciar	25
4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës	28

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e Eurozonës, sipas vlerësimeve të Eurostat-it, shënoi rritje vjetore prej vetëm 0.4 përqind në TM1 2024, e një rritje tremujore prej 0.3 përqind. Rritja e ngadalësuar ekonomike u ndikua nga normat ende të larta të interesit që frenuan konsumin dhe investimet. Komponentët kryesor që ndikuan në rritjen ekonomike të Eurozonës në TM1 2024 ishin konsumi final i ekonomive shtëpiake prej 0.1 pikë përqindje dhe eksporti neto prej 0.9 pikë përqindje, ndërsa formimi i bruto kapitalit dhe inventari kontribuan negativisht prej 0.3 pikë përqindje. **Projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE-ja janë rishikuar në qershor 2024 kundrejt projeksioneve të marsit, në 0.9 përqind për vitin 2024 dhe 1.4 përqind për vitin 2025.** Konsumi privat pritet të jetë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike, duke i'u atribuar rënies së inflacionit dhe rritjes së të ardhurave reale. Për më tepër, rënia e pasigurisë dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve pritet të japin mbështetje shtesë për konsumin privat.

Shkalla e inflacionit në TM1 2024 ka arritur në 2.6 përqind, duke shënuar rënie të dukshme kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar (8.0 përqind në TM1 2023). Projeksionet e BQE-së sugjerojnë një ngadalësim të inflacionit në 2.5 përqind në 2024 dhe 2.2 përqind në vitin 2025. Megjithatë, dinamikat e inflacionit mund të ndikohen përgjatë viteve projektuese me përkeqësimin e mëtejshëm të tensioneve aktuale gjeopolitike, veçanërisht në Lindjen e Mesme, duke u reflektuar në çmimet potenciale të energjisë dhe kostot e mallrave. Duke konsideruar ngadalësimin e vazhdueshëm të inflacionit (2.6 përqind në TM1 2024), në takimin e BQE-së të mbajtur në qershor 2024 vendosi të ulë normat e interesit për 0.25 pikë bazë. Normën e interesit në depozita në 3.75 përqind, normën në operacionet e ri financimit në 4.25 përqind dhe normën marginale për huadhënie në 4.50 përqind. Normat ende të larta të interesit pritet të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike në muajt e ardhshëm, duke sjellë presion mbi BQE-në për të shqyrtuar mundësinë e uljes së normave kyçe të interesit gjatë vitit 2024.

Projeksionet e FMN-së, të realizuara në prill 2024, sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje mesatare ekonomike prej 3.0 përqind në vitin 2023 dhe pritet të shënojnë një rritje prej 3.2 përqind në 2024. Rritja ekonomike pritet të ndikohet nga presionet e jashtme, duke përfshirë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë, si dhe nga efektet e brendshme si përballja me inflacionin dhe kosto ende të lartë të financimit. Shkalla mesatare e inflacionit në TM1 2024 rezulton të ketë qenë 3.5 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 5.7 përqind, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina rezulton të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 2.0 përqind.


Në TM1 2024, tregu i këmbimit valutor i euros kundrejt valutave të partnerëve tregtar u vlerësua në krahasim me lirën turke dhe dollarit amerikan kundrejt tremujorit paraprak. Vlera e valutës euro u zhvlerësua kundrejt lekut shqiptar, sterlina britaneze dhe frangut zviceran, ndërsa mbeti pothuajse e njëjtë ndaj denarit maqedonas.

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare vazhduan të lehtësohen përgjatë TM1 2024. Indeksi i çmimeve të mallrave bazë, sipas Bankës Botërore, shënoi rënie në TM1 2024 kundrejt tremujorit paraprak, mbështetur njëkohësisht nga ngadalësimi i kërkesës dhe përmirësimi i ofertës. Ndikimi i konflikti në Lindjen e Mesme ishte marginal duke kontribuar në një rritje të lehtë të çmimeve të naftës dhe arit. Ndërkohë, ndikimi i pengesave në transport në Detin e Kuq ishte i kufizuar. Çmimet pritet të ndjekin ecuri rënëse përgjatë vitit 2024, por rreziqet potenciale si përkeqësimi i tensioneve gjeopolitike, ndikimi i kushteve klimatike në ofertën e mallrave ushqimore, reduktimi i prodhimit të naftës nga OPEC+, etj., mund të ndryshojnë këtë ecuri.

Në TM1 2024, çmimet e naftës së papërpunuar brent, sipas Bankës Botërore, arritën në \$83.1 për fuçi, që paraqet rritje prej 2.1 përqind kundrejt TM1 2023, si pasojë e goditjeve në ofertë (grafiku 1). Në krahasim me tremujorin paraprak, çmimet e naftës shënuan rënie prej 1.1 përqind, për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global. Përgjatë tremujorit, u evidentuan presione inflacioniste me rritjen e shqetësimeve rreth sigurisë së furnizimit si pasojë e konfliktit në Lindjen e Mesme, vazhdimin e reduktimeve në ofertë nga OPEC+, dhe sulmet e ndërsjella mes Rusisë dhe Ukrainës me target infrastrukturën energjetike. Sidoqoftë, efekti i ngadalësimit të kërkesës globale dhe rritja e prodhimit të naftës nga SHBA-të neutralizuan këto presione me çmimet e naftës brent që ranë në \$81 për fuçi në maj. Sipas Bankës Botërore, mesatarja vjetore e çimitit të naftës brent për vitin 2024 pritet të sillet rreth \$84 për fuçi, me rreziqet që anojnë nga kahu i lartë kryesisht nga pengesat potenciale në ofertë.


Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Çmimet e gazit natyror në Evropë në TM1 2024 ranë në \$8.8/mmbtu, duke u përgjysmuar kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak (grafiku 1). Ngjashëm, rënie e dukshme prej 35.3 përqind u evidentua në raport me tremujorin e mëparshëm, mbështetur nga rezervat e mjaftueshme dhe kushtet e lehta klimatike. Sidoqoftë, në mars u evidentuan presione inflacioniste nga rritja e kërkesës për gaz natyror në Azi dhe shqetësimet pas reduktimeve të paplanifikuara në furnizim nga Norvegjia, që shpërfaqti ndjeshmërinë e tregut ndaj pasigurive përkundër niveleve të mjaftueshme të rezervave. Çmimet e gazit natyror në Evropë pritet të shënojnë mesatare vjetore prej \$9.5/mmbtu në 2024, me rreziqe që anojnë nga kahu i lartë kryesisht nga tensionet gjeopolitike dhe kushtet klimatike.

Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rënie prej 9.2 përqind krahasuar me TM1 2023 si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, i ndikuar ndjeshëm nga ngadalësimi në sektorin e ndërtimit në Kinë (grafiku 2). Ecuri rënëse në terma vjetorë u evidentuan në të gjitha kategoritë e metaleve dhe mineraleve në kuadër të indeksit. Në krahasim me tremujorin paraprak, ky indeks shënoi rritje prej 0.5 përqind, e nxitur nga rritja e çmimeve të bakrit, aluminit dhe kallajit, si pasojë e pengesave në ofertë si kufizimet tregtare dhe reduktimi i prodhimit që pritet të vazhdojnë përgjatë vitit. Kjo pritet të ndikojë në ruajtjen e nivelit të çmimeve, pavarësisht ngadalësimit të kërkesës. Rreziqet potenciale për lartë përfshijnë kufizimet e mëtejshme tregtare dhe rritjen e aktivitetit industrial në Kinë.


Grafik 2. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara ishte 8.6 përqind më i lartë në TM1 2024 kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak (grafiku 2). Rritje u evidentua edhe në raport me tremujorin paraprak, kur ky indeks u ngrit për 4.2 përqind si pasojë e rritjes së çmimit të arit prej 4.9 përqind. Kjo rritje i atribuohet kryesisht blerjes së arit nga disa Banka Qendrore dhe, në masë më të vogël, përdorimit të arit si aset për shmangie të rrezikut. Çmimet e arit pritjet të vijnë të rriten, duke rezultuar në rritje mesatare vjetore prej 8.1 përqind në vitin 2024.

Indeksi i çmimeve të ushqimit në TM1 2024, sipas FAO-s¹, shënoi rënie vjetore prej 9.4 përqind kundrejt periudhës korresponduese në vitin paraprak (grafiku 3). Kjo rënie reflekton rënien e dukshme të çmimeve të drithërave, bulmetit dhe vajrave. Çmimet e ushqimit vazhduan të lehtësohen edhe kundrejt tremujorit paraprak, duke shënuar rënie prej 1.9 përqind. Të gjitha kategoritë e ushqimit shënuan rënie, përveç çmimeve të bulmetit që vazhduan të nxiten nga rritja e kërkesës (grafik 3). Ecuria e çmimeve të drithërave varioi mes kategorive, me çmimet e grurit që shënuan rënie si rezultat i rritjes së konkurrencës mes eksportuesve global pas rënies së kërkesës nga Kina, ndërsa çmimet e misrit shënuan rritje për shkak të pengesave logjistike në Ukrainë. Çmimet e vajit u ndikuan nga rënia e rendimentit krahas kërkesës së qëndrueshme. Kurse, çmimet e sheqerit shënuan rënie si rezultat i përmirësimit të pritjeve për rendiment në Indi dhe Tajlandë. Lehtësimet në çmimet e ushqimit pritjet të vazhdojnë përgjatë vitit 2024, kryesisht bazuar në pritjet për ofertë të qëndrueshme.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



¹ Food and Agricultural Organization of the United Nations (FAO) Food Price Index - Indeksi i Çmimeve të Ushqimit i Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë i Kombeve të Bashkuara.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Rritja Ekonomike

Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 5.6 përqind në TM1 2024. Përshpejtimi i rritjes ekonomike kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar lidhet kryesisht me dinamikën e kërkesës vendore, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik si rezultat i rritjes së kërkesës vendore që u shoqërua me rritje të importit, liberalizimit të vizave që ka ndikuar në rritjen e importit të shërbimeve të udhëtimit, dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe kërkesa e dobësuar në Eurozonë.

Parashikimet sugjerojnë se ekonomia e Kosovës pritet të rritet më shpejtë gjatë vitit 2024, e mbështetur nga rritja e të ardhurave reale të disponueshme, falë uljes së inflacionit dhe rritjes së burimeve të financimit. Sipas projeksioneve të BQK-së, ekonomia pritet të rritet me 3.9 përqind gjatë vitit 2024. Kjo rritje pritet të mbështetet nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë një ndikim negativ në rritjen e BPV-së.


Rritja ekonomike në TM1 2024 është mbështetur kryesisht nga konsumi dhe investimet, që kontribuan me 9.1 përkatësisht 1.0 pikë përqindje. Në anën tjetër, eksportet neto patën një ndikim negativ në rritjen reale të BPV-së me 4.5 pikë përqindje (grafiku 4).

Në TM1 2024, konsumi është rritur për 8.9 përqind, një rritje shumë më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Investimet shënuan rritje për 3.1 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së investimeve publike dhe kreditimi. Sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto thelluan deficitin tregtar për 12.7 përqind. Rritja e deficitit tregtar ishte pasojë e rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 9.1 përqind (importi i mallrave shënoi rritje për 6.9 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje për 30.8 përqind), si dhe rënies së eksportit të mallrave për 1.9 përqind, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje për 14.0 përqind.

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM1 2024 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz (3.8 përqind), aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit (2.3 përqind), hoteleve dhe restoranteve (1.6 përqind), industrisë nxjerrëse (1.4 përqind), industrisë përpunuese (1.3 përqind), tregtisë (1.2 përqind), etj.


Aktiviteti ekonomik u reflektua në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, duke arritur në 3,249 ndërmarrje të reja në TM1 2024, një rritje prej 5.3 përqind krahasuar me TM1 2023. Sektori i tregtisë,

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

informacionit dhe komunikimit, ndërtimtarisë, transportit, etj., shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara. Këta sektorë treguan një rritje të ndjeshme në numrin e ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 (grafiku 5). Gjithashtu, gjatë TM1 2024, u mbyllën 6.9 përqind më shumë ndërmarrje krahasuar me TM1 2023, apo 467 ndërmarrje gjithsej.

3.2. Çmimet

Inflacioni vazhdoi të ndjekë trend ngadalësimi, duke rezultuar 2.1 përqind në TM1 2024 nga 2.8 përqind sa ishte në tremujorin paraprak. Ngadalësimi i inflacionit u mbështet nga zbutja e presioneve të jashtme inflacioniste si rrjedhojë e stabilizimit të ofertës dhe rënies së çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Në TM1 2024, inflacioni në Kosovë u përcaktua nga rritja e ngadalësuar e çmimeve të ushqimit, shërbimeve dhe mallrave tjera, ndërsa energjia kontribuoi pozitivisht në inflacion pas tre tremujorëve me efekt lehtësues në inflacion (grafiku 6).

Grafik 6. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Rritja e çmimeve të ushqimit u ngadalësua në 1.0 përqind në TM1 2024, nga 3.0 përqind në tremujorin paraprak. Ngadalësim u evidentua në të gjitha kategoritë e ushqimit me përjashtim të çmimeve të peshkut. Sidoqoftë, rritja vjetore vazhdoi të mbetet ende e lartë në çmimet e frutave (11.1 përqind në TM1 2024), peshkut (9.4 përqind), sheqerit dhe produkteve të tij (6.6 përqind), prodhimeve ushqimore (5.4 përqind) e të tjera. Në anën tjetër, u evidentua rënie në çmimet e qumështit, djathit, dhe vezëve prej 5.0 përqind, dhe vajrave prej 6.3 përqind. Përkundër rënies/ngadalësimit në çmimet e artikujve ushqimorë, çmimet e ushqimit mbeten rreth 30 përqind mbi nivelet e tyre para luftës në Ukrainë, duke vazhduar të rëndojnë mbi të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare, marrë parasysh peshën e ushqimit në shportën e konsumit në vend (30.3 përqind).

Çmimet e transportit shënuan rënie vjetore prej 1.8 përqind që përbën ngadalësim të mëtutjeshëm nga norma prej -1.5 përqind në tremujorin paraprak. Kjo rënie u diktua nga rënia vjetore prej 1.0 përqind në çmimet e automjeteve dhe rënia megjithëse e ngadalësuar prej 2.9 përqind në çmimet e karburanteve. Në anën tjetër, shërbimet e transportit u karakterizuan me presione inflacioniste duke rezultuar në rritje vjetore prej 4.6 përqind.

Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM1 2024 u zvogëlu në 0.3 pikë përqindje nga 1.0 pikë përqindje në tremujorin paraprak. Kontributi më i lartë u regjistrua nga rritja e çmimeve të bukës dhe drithërave, perimeve, dhe frutave. Kontributi i energjisë në inflacionin e përgjithshëm në TM1 2024 u rrit në 0.2 pikë përqindje, nga rritja vjetore e çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse të ngurta për shkak të rritjes së kërkesës për ngrohje. Kontributi i çmimeve të mallrave tjera shënoi rënie të lehtë në 0.8 pikë përqindje në TM1 2024 bazuar në ngadalësimin e çmimeve të duhanit dhe rënien e

Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.


çmimeve të blerjes së automjeteve. Kurse, kontributi i shërbimeve në gjithsej IÇK-në u zvogëluar në 0.5 pikë përqindje (nga 0.7 pikë përqindje në TM4 2023) si pasojë e rritjes së ngadalësuar në çmimet e disa shërbimeve, në veçanti atyre hoteliere.

Inflacioni bazë në TM1 2024 shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind, duke stagnuar kundrejt tremujorit paraprak, si pasojë e rritjes vjetore të çmimeve të shërbimeve të transportit dhe të strehimit që neutralizuan plotësisht ngadalësimin e presioneve inflacioniste në kategoritë tjera (grafiku 7).

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe pjesëmarrja e lartë e këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në TM1 2024, 1.4 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 0.7 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 8).

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) shënoi rritje vjetore prej 2.4 përqind në TM1 2024, që paraqet përshpejtim kundrejt rritjes vjetore prej 1.0 përqind në tremujorin paraprak. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi që përfshijnë: i) mjetet e transportit, ii) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, dhe iii) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike shënuan rritje vjetore prej 9.6, 6.1 dhe 1.2 përqind respektivisht, ndërsa iv) metalet bazë dhe artikujt përkatës, dhe v) produktet minerale shënuan rënie vjetore prej 3.4 respektivisht 1.5 përqind. Në raport me tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rritje prej 2.5 përqind si rezultat i rritjes së çmimeve në të gjitha kategoritë e indeksit, me përjashtim të çmimeve të importit të drurit dhe artikujve përkatës që shënuan rënie të lehtë në nivel tremujor.

Grafik 8. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi me rënie prej 0.9 përqind në TM1 2024 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të prodhimit të energjisë elektrike (-3.4 përqind), mineraleve jometalike (-0.1 përqind), mobileve (-6.2), e të tjera. Ndërsa, çmimet e përpunimit të produkteve ushqimore dhe prodhimit të pijeve shënuan rritje vjetore prej nga 2.6 përqind secila. Indeksi i çmimeve të prodhimit shënoi rënie edhe kundrejt tremujorit paraprak, prej 0.4 përqind, i diktuar nga dinamika të ngjashme, me përjashtim të çmimeve të prodhimit të metaleve që u ngritën lehtë në nivel tremujor.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) në TM4 2023 shënoi rritje vjetore prej 0.7 përqind. Kjo rritje u nxit dukshëm nga rritja e pagave në ndërtimtari (9.6 përqind), rritja e çmimeve të materialeve ndërtimore (0.5 përqind), dhe transportit (3.2 përqind). Ndërsa, u evidentua rënie në çmimet e makinerive dhe energjisë. Në raport me TM4 2023, IKN rezultoi me rënie prej -0.3 përqind, si pasojë e rënies së çmimeve të energjisë dhe makinerive dhe rritjes më të ngadalshme të pagave në ndërtimtari në nivel tremujor.

Sa i përket perspektivës së inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2024 të ngadalësohet në 2.5 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë stabilizimin e ofertës dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare krahas ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Rreziqet e ndërlidhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa në zinxhirët e furnizimit si pasojë e tensioneve gjeopolitike, reduktim të sasisë së prodhimit nga OPEC+, ndikim të migrimit potencial në paga pas liberalizimit të vizave, përshpejtim potencial të kërkesës, e të tjera.

3.3 Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore² në TM1 2024 arritën vlerën neto prej 692.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.1 përqind. Faktorët kryesorë që kontribuan në këtë rritje përfshijnë aktivitetin ekonomik, përpjekjet për formalizimin e ekonomisë dhe përmirësimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet primare buxhetore³ u rritën për 14.7 përqind, duke arritur në 561.9 milionë euro. Si rezultat i kësaj rritjeje më të lartë të të hyrave buxhetore, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej 130.3 milionë euro.

Të hyrat tatimore në TM1 2024 arritën në 626.8 milionë euro, duke shënuar rritje prej 17.4 përqind krahasuar me TM1 2023. Gjatë kësaj periudhe, pothuajse të gjitha kategoritë e tatimeve shënuan rritje. Rritja më e lartë u evidentua tek të hyrat tatimore indirekte, të cilat përbënin rreth 74.2 përqind të gjithë të hyrave buxhetore. Këto të hyra shënuan rritje prej 18.5 përqind, duke arritur vlerën 513.2 milionë euro.


Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 11.8 përkatësisht 12.1 përqind, ndërsa tatimi i akcizës shënoi rritje edhe më të lartë (39.5 përqind), si rezultat i rritjes së sasisë së mallrave të importuara, kryesisht cigareve, derivateve të naftës, automjeteve, etj. (grafiku 9). Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 7.6 përqind, duke arritur vlerën prej 125.7 milionë euro. Kjo rritje u ndikua nga përmirësimi i procesit të mbledhjes së të hyrave, aktiviteteve për luftimin e evazionit tatimor dhe forcimit të përmbushjes vullnetare nga tatimpaguesit. Brenda kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore, shënoi rritje vjetore prej 14.3 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind.

Përveç të hyrave tatimore, edhe të hyrat jo-tatimore shënuan rritje të lartë prej 14.7 përqind, duke arritur në 65.3 milionë euro. Në këtë kategori, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 39.6 milionë euro duke shënuar rritje prej 30.3 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rënie për 11.5 përqind, duke arritur vlerën 13.2 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan një rritje më të ngadalësuar prej 5.6 përqind. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga shënuan rritje prej 19.2 përqind dhe arritën vlerën 215.7 milionë euro, shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 15.7 përqind dhe arritën vlerën 70.6 milionë euro, ndërsa shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rënie për 9.3 përqind dhe arritën vlerën 188.0 milionë euro. **Ndërsa, shpenzimet kapitale shënuan rritje tre shifrore prej 116.0 përqind duke arritur vlerën 87.4 milionë euro.**

Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 15.6 përqind në TM1 2024, krahasuar me 18.1 përqind në TM1 2023. Kjo ulje e raportit të borxhit publik ndaj BPV-së rezultoi nga përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë, gjë që ulë nevojën për borxh. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.64 miliardë euro në TM1 2024,

Grafik 9. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë grantet dhe pranimet nga financimi.


³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë grantet dhe pagesat për financim.

duke shënuar rënie prej 112.1 përqind krahasuar me TM1 2023. Zvogëlimi i borxhit publik ishte rezultat i uljes së borxhit të brendshëm publik për 165.4 përqind, duke arritur në 945.0 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 53.3 përqind dhe arriti në 698.0 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (36 përqind), Bashkimit Evropian (14 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (12 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (10 përqind), etj. Në anën tjetër, borxhi i brendshëm përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (46 përqind), bankave komerciale (24 përqind), institucioneve publike (22 përqind), etj.

3.4. Sektori i jashtëm


Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti vlerën prej 318.9 milionë euro në TM1 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 40.4 përqind (227.2 milionë euro në TM1 2023). Bilanci i llogarisë rrjedhëse në TM1 2024 ka vazhduar të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave, komponentë e cila u përkeqësua si pasojë e rritjes së importit të mallrave dhe rënies së eksportit. Ndërkaq, të ardhurat parësore, të ardhurat dytësore dhe shërbimet ndikuan në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse (grafiku 10).



Kategoria e mallrave në TM1 2024 shënoi rritje vjetore të deficitit prej 12.0 përqind, duke arritur vlerën prej 1.16 miliardë euro (grafiku 11). Arsyeja kryesore e rritjes së deficitit tregtar ndërlidhet me vlerën e lartë të importit të mallrave dhe rënien e eksportit. Eksporti i mallrave në TM1 2024 mbuloi vetëm 15.4 përqind të importeve, respektivisht 1:6.5 raporti tregtar.

Eksporti i mallrave në TM1 2024 shënoi rënie vjetore prej 2.7 përqind, duke arritur vlerën prej 211.2 milionë euro (217.1 milionë euro në TM1 2023). Rënia e eksportit të mallrave kryesisht i atribuohet dobësimit të kërkesës së jashtme (sasia e mallrave të eksportuar shënoi rënie prej 18.1 përqind) dhe pjesërisht nga dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Mirëpo, pavarësisht rënies së lehtë të eksportit, kategoritë me pjesëmarrjen më të madhe shënuan rritje vjetore, eksporti i metaleve bazë ka shënuar rritje prej 31.0 përqind në TM1 2024, duke arritur vlerën prej 55.3 milionë euro (42.2 milionë euro në TM1 2023). Ndërsa, eksporti i produkteve të plastikës shënoi rritje vjetore prej 9.2 përqind duke arritur vlerën prej 29.4 milionë euro (grafik 12). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM1 2024 ishin shtetet e Ballkanit Perëndimor me një pjesëmarrje prej 39.2 përqind të gjithëj mallrave të eksportuara dhe vendet BE-së me një pjesëmarrje prej 33.7 përqind, ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania, me 10.8 përqind të gjithëj eksporteve kosovare.


Grafik 11. Bilanci tregtar i mallrave



Mallrat e importuara në TM1 2024 arritën vlerën prej 1.37 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 9.5 përqind. Struktura e mallrave të importuara vazhdon të dominohet nga importi i produkteve minerale, artikujt ushqimorë dhe mjetet e transportit (grafik 13). Importi sipas kategorive kryesore u dominua nga mallrat e ndërmjetme, me 47.0 përqind, mallrat konsumuese, me 33.2 përqind, ndërsa kategoria e mallrave kapitale mbetet e ulët, me 9.6 përqind të importit të përgjithshëm. Dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ndikuan në rritjen e sasisë së mallrave të importuara, veçanërisht në kategorinë e mallrave të ndërmjetme dhe mallrave konsumuese, të cilat shënuan rritje të importit prej 7.3 dhe 9.2 përqind. Struktura e partnerëve tregtar mbeti e pa ndryshuar, me Bashkimin Evropian që kryeson me rreth 46.3 përqind të importeve, ku Gjermania vazhdon ta ketë peshën kryesore prej 14.2 përqind të gjithsej importeve kosovare. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 14.7 përqind të importit të përgjithshëm apo 201.3 milionë euro. Ndërkohë, importi i mallrave nga Turqia arriti vlerën prej 223.7 milionë euro apo 16.3 përqind të vlerës së përgjithshme të importeve.


Shërbimet kanë vazhduar të kontribuojnë pozitivisht në kuadër të llogarisë rrjedhëse, duke shënuar rritje prej 4.5 përqind, duke arritur vlerën prej 270.8 milionë euro në TM1 2024 (grafik 14). Eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 16.1 përqind dhe arriti vlerën prej 571.2 milionë euro. Rritja e eksportit të shërbimeve ishte kryesisht rezultat i rritjes së shërbimeve të udhëtimit prej 12.7 përqind, kategori që arriti vlerën prej 370.9 milionë euro, ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të udhëtarëve për 29.2 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në rritjen e eksportit të shërbimeve kontribuoi edhe kategoria e shërbimeve të teknologjisë informative, që shënoi rritje prej 26.9 përqind dhe arriti vlerën prej 73.5 milionë euro nga 57.9 milionë euro sa ishte në TM1 2023. Në anën tjetër, importi i shërbimeve ka arritur vlerën prej 300.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 29.0 përqind, duke ndikuar në ngadalësimin e rritjes së bilancit pozitiv të shërbimeve. Rritja e importit të shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve të udhëtimit, e cila përbënë 43.8 përqind të vlerës së përgjithshme të importit të shërbimeve, duke arritur vlerën prej 131.7 milionë euro në TM1 2024 (86.3 milionë euro në TM1 2023). Importi i shërbimeve të

Garfik 12. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro




Burimi: BQK.

Garfik 13. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Grafik 14. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

udhëtimit shënoi rritje si rezultati i vizitave më të shpeshta të qytetareve nga Kosova në vendet e BE-së pas liberalizimit të vizave, duke shënuar rritje vjetore në numrin e fluturimeve nga ANP për 26.3 përqind në TM1 2024, si dhe 24.3 përqind më shumë pasagjerë të kontrolluar në dalje në pikat doganore në TM1 2024 kundrejt TM1 2023.

Bilanci i të ardhurave parësore ka arritur në 24.4 milionë euro në TM1 2024 (7.5 milionë euro në TM1 2023). Rritja e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga të ardhurat e kompensimit të punëtorëve, bilanci i të cilave arriti vlerën prej 96.4 milionë euro, një rritje prej 31.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, bilanci i të ardhurave nga investimet ishte negativ prej 69.9 milionë euro në TM1 2024, si pasojë e të ardhurave nga investimet direkte në vlerë prej 80.2 milionë euro (grafiku 15). Ndërkaq, investimet portfolio shënuan bilanc pozitiv prej 8.5 milionë euro, ndikuar kryesisht nga letrat me vlerë, e ndjekur nga investimet tjera me bilanc negativ prej 1.4 milionë euro dhe asetet rezervë me bilanc pozitiv prej 3.0 milionë euro.


Vlera e remitencave të pranura në TM1 2024 ka arritur në 281.0 milionë euro, duke shënuar rritje prej 3.6 përqind krahasuar me TM1 2023 (grafiku 16).

Grafik 15. Bilanci i të ardhurave parësore




Burimi: BQK.

Grafik 16. Remitencat




Burimi: BQK.

Grafik 17. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Grafik 18. IHD-të sipas aktiviteteve kryesore



Burimi: BQK.

Rritja e ngadalësuar e remitencave në tre mujorin e parë pas liberalizimit të vizave me vendet e BE-së, mund të jetë ndikuar nga rritja e vizitave të kosovarëve në diasporë, të cilët ofrojnë mbështetje financiare për familjaret e tyre për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit. Remitencat vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, që përbëjnë rreth 55.5 përqind të gjithsej remitencave. Remitencat përmes kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje vjetore prej 3.0 përqind në TM1 2024, ndërsa është shënuar rritje prej

5.8 përqind e dërgesave përmes kanaleve të tjera, potencialisht ndikuar nga rritja e vizitave të kosovarëve në diasporë.

IHD-të në TM1 2024 arritën vlerën prej 214.7 milionë euro, duke shënuar rritje prej 13.2 përqind kundrejt TM1 2023 (grafiku 17). Rritja e IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorin e patundshmërisë, me një rritje prej 34.7 përqind, duke arritur vlerën prej 141.9 milionë euro, që përbën rreth 66.1 përqind të gjithë IHD-ve. Rritja e IHD-ve kishte edhe në sektorin e energjisë elektrike, tregtisë dhe në sektorin financiar përfshirë sigurimet. Investimet direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rënie prej 24.5 përqind në TM1 2024, duke arritur vlerën prej vetëm 37.1 milionë euro në krahasim me 49.1 milionë euro sa ishte në TM1 2023, investime të destinuara kryesisht në vendet e rajonit e të orientuara në sektorin e patundshmërisë.

4. Sistemi financiar

Sistemi financiar në vend ka vazhduar të zgjerohet edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024, por me ritëm më të ngadalësuar. Asetet e sistemit financiar në mars 2024 arritën vlerën 11.25 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.7 përqind (grafiku 19). Sektori bankar dhe ai i sigurimeve u karakterizuan me ngadalësim të shkallës së rritjes vjetore të aseteve, përderisa me rritje të përshpejtuar u karakterizuan fondet pensionale dhe sektori mikrofinanciar.


Sektori bankar në mars 2024 përfaqësoi 66.5 përqind të gjithë aseteve të sistemit financiar, dhe ndaj dhe për shkak të peshës së lartë në sistem dha kontributin kryesor në zgjerimin e tij përkundër rritjes vjetore më të ngadalshme (grafiku 20). Fondet pensionale shënuan përshpejtim të theksuar të rritjes vjetore dhe rrjedhimisht rritën pjesëmarrjen në gjithë asetet e sektorit financiar në 25.5 përqind. Kurse, ndihmësit financiar që përbëjnë vetëm 0.1 përqind të aseteve të sistemit financiar, shënuan rënie vjetore, dhe kontribut negativ në nivel marginal.

4.1. Sektori bankar

Asetet e sektorit bankar arritën vlerën 7.48 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.6 përqind, për 5.6 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 21). Kjo dinamikë u ndikua nga aktiviteti kreditues - si aktiviteti kryesor i sektorit bankar - i cili ngadalësoi ritmin e rritjes krahasuar me vitin paraprak. Ambienti i normave më të larta të interesit ndikoi që zëri i investimeve në letrat me vlerë të rritet me ritëm të lartë për të dytin vit me radhë, ndërsa zërat me kthim më të ulët si bilanci në bankat tjera, dhe zëri i parash së gatshme dhe bilanci me BQK-në shënuan rënie, përkatësisht ngadalësim të rritjes.


Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 12.8 përqind, për 2.0 pikë përqindje më ulët se viti paraprak. Ky zhvillim reflekton trendin më të ngadalësuar të rritjes së kreditimit për korporatat jofinanciare, ngase kreditë për ekonomitë familjare përshpejtuan shkallën e rritjes vjetore (grafiku 22 dhe 23). Sipas Anketës së Kreditimit Bankar (AKBK), dinamikat e kreditimit edhe në tremujorin e parë të vitit 2024, sikurse gjatë tremujorit të fundit

Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet



Burimi: BQK.

të vitit 2023, u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime më të vogla: lehtësimi deri në një masë për ekonomitë familjare, kurse për ndërmarrjet standarde kryesisht të pandryshuara.


Ngadalësimi i rritjes së gjithsej kreditimit, ndikuar prej ecurisë së kreditimit për korporatat jofinanciare, korrespondon me qarkullimin më të ulët të kompanive, i cili shënoi rritje për vetëm 4.5 përqind në TM1 2024 krahasuar me 13.4 përqind rritje në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Ngadalësim të qarkullimit kishte për sektorin e tregtisë dhe të prodhimit, kurse me rënie të qarkullimit u karakterizua sektori i ndërtimit, sektor këta që kanë peshë të lartë në portfolion kreditore të bankave.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 9.5 përqind, për 4.4 pikë përqindje më ulët se viti paraprak. Ngadalësim të kreditimit kishte në sektorët me peshë më të lartë në kreditim, siç janë ai i tregtisë dhe prodhimit, që së bashku përfaqësojnë 60.8 përqind të stokut të kredive për këtë segment. (grafik 24). Bujqësia vazhdon të jetë një ndër aktivitetet më pak të kredituara prej sektorit bankar, por që në dy vitet e fundit ka shënuar rritje të theksuar, mbështetur edhe nga Fondi i Kosovës për Garanci Kreditore (FKGK-ja) (grafik 25). **Kreditë për ekonomitë familjare shënuan përsheptim të rritjes vjetore në 17.9 përqind nga 16.1 përqind në vitin paraprak.** Rritja e lartë u evidentua edhe nga rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar, për TM1 2024, që sugjerojnë për kërkesë të lartë nga ky segment për të financuar nevojat për konsum dhe për blerje të shtëpive, si dhe ofertë deri në një masë më të lehtësuar.

Dinamika e kredive të reja gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të përsheptuar, për dallim nga stoku i kreditimit që shënoi ngadalësim të rritjes. Gjithsej kreditë e reja u rritën për 12.5 përqind, kundrejt rënies për 6.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Segmenti i korporatave jofinanciare u karakterizua me rritje vjetore prej 1.4 përqind nga rënia prej 3.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak; ndërsa ai i ekonomive familjare shënoi rritje të përsheptuar prej 28.1 përqind nga rënia prej 3.7 përqind (grafiku 26).

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik




Burimi: BQK.

Në kuadër të KJF-ve, me rritje u karakterizuan kreditë e reja me karakter investues, të cilat u rritën për 3.7 përqind nga rënia prej 3.9 përqind një vit më parë, ndërsa kreditë me karakter jo-investues shënuan rënie vjetore prej 2.8 përqind nga 4.6 përqind rritje. Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, kreditë e reja personale/individuale/konsumuese shënuan rritje të theksuar vjetore prej 31.5 përqind nga rritja prej 5.9 përqind që kishin në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Ndërsa, kreditë e reja hipotekare rikuperuan trendin rritës të viteve paraprake, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind nga rënia prej 22.8 përqind një vit më parë. **Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet kryesisht nga depozitat e klientëve, të cilat në tremujorin e parë të vitit 2024 u karakterizuan me rritje vjetore më të ngadalshme.** Vlera e gjithsej depozitave arriti në 6.05 miliardë euro (grafiku 27), që paraqet rritje prej 8.9 përqind kundrejt rritjes prej 17.1 përqind një vit më parë. Të dy segmentet kryesore, përkatësisht korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare shënuan ngadalësim të trendit të rritjes së depozitave, në 12.4 përqind nga 21.5 përqind, respektivisht 8.7 përqind nga 11.8 përqind rritje një vit më parë. Ndërsa, depozitat e korporatave publike shënuan rënie, duke shtuar kontributin në ngadalësimin e përgjithshëm të rritjes së depozitave. Depozitat e korporatave tjera financiare, që kryesisht janë depozita të fondeve pensionale, shënuan rritje shumë më të ngadalësuar krahasuar me rritjen e lartë të një viti më parë, si rezultat i koncentrimin më të lartë në investimet jashtë vendit (grafiku 28). Në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, depozitat përbënin 80.9 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit, rënie për 1.3 pikë përqindje nga tremujori i parë i vitit paraprak.


Depozitat e reja, që nënkuptojnë vetëm depozitat e afatizuara, vazhduan rritjen me ritëm të lartë, duke iu atribuar ambientit me norma më të larta të interesit dhe vazhdimin të kampanjave të bankave për tërheqje të depozitave. Në fund të marsit 2024, këto depozita arritën vlerën prej 238.8 milionë euro nga 152.6 milionë vitin e kaluar, e që paraqet një rritje vjetore prej 56.5 përqind, nga 63.0 përqind një vit më parë. Depozitat e reja të ekonomive familjare shënuan rritje më të

Grafik 25. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike




Burimi: BQK.

Grafik 26. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave




Burimi: BQK.

lartë, prej 61.9 përqind nga rritja prej 29.3 përqind një vit më parë, duke arritur në 156.1 milionë euro (96.4 milionë euro në TM1 2023). Depozitat e reja të korporatave jo-financiare gjithashtu shënuan rritje të lartë, duke arritur vlerën prej 82.7 milionë euro nga 56.2 milionë euro një vit më parë (grafiku 29).


Trendi rënës i inflacionit dhe sinjalet pozitive nga Banka Qendrore Evropiane për ulje të normave bazë të interesit në një të ardhme të afërt, kanë ndikuar në ulje të presioneve në normat e interesit në sektorin bankar në vend. Por, presionet konkurruese për tërheqje të depozitave për të financiar rritjen mbeten të larta. Në mars të vitit 2024, norma e interesit në kredi zbriti në 6.2 përqind nga 6.3 përqind sa ishte në fillim dhe në fund të vitit 2023. Ndërsa norma e interesit për depozita arriti në 2.7 përqind, duke shënuar normën më të lartë krahasuar me vitet e fundit (1.8 përqind norma e interesit për depozita në mars të vitit 2023). Sidoqoftë, krahasuar me tremujorin paraprak, norma e interesit në depozita shënoi rënie të lehtë prej 0.4 pikë përqindje. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në mars 2024 në 3.5 pikë përqindje nga 4.5 pikë përqindje në mars 2023, për shkak të rritjes më të lartë të normës së interesit në depozita dhe rënies së lehtë në ato të kredive (grafiku 30). Kurse, krahasuar me tremujorin paraprak, ky hendek u rrit për 0.3 pikë përqindje për shkak të rënies më të theksuar të normave të interesit në depozita, kundrejt atyre për kredi.

Rënia e presioneve inflacioniste dhe dinamikat pasuese në normën e interesit ndikuan që trendi i rritjes së kredive me normë variable të interesit të ndryshoj kahje. Rrjedhimisht, në mars 2024, pjesëmarrja e kredive me normë variable të interesit zbriti në 31.8 përqind nga 33.9 përqind në tremujorin paraprak. Kjo pjesëmarrje vazhdon të jetë më e lartë krahasuar me një vit më parë, ku pjesëmarrja e kredive me normë variable të interesit ishte 29 përqind e gjithsej portfolios kreditore (grafiku 31).

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.


Grafik 31. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.


Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në mars 2024 arriti në 6.6 përqind, që është për 0.1 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Në kuadër të KJF-ve, norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për sektorin e shërbimeve prej 6.2 përqind (grafiku 32). Ndërsa, **norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare zbriti në 5.8 përqind, apo rënie vjetore prej 0.27 pikë përqindje.** Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare, me një mesatare prej 5.0 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët pasi kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.0 përqind sa ishin në mars 2024 (grafiku 33).

Grafik 32. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Grafik 33. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Normat e interesit në depozita shënuan trend të rënies në tremujorin e parë të vitit 2024, për dallim nga trendi rritës që nga muaji qershor i vitit 2022. Megjithatë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar normat e interesit shënuan rritje për 0.9 pikë përqindje, duke arritur në 2.7 përqind në mars 2024. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare është rritur për 1.3 pikë përqindje, duke arritur në 3.3 përqind, dhe për ekonomitë familjare është rritur për 0.8 pikë përqindje, duke arritur në 2.5 përqind në mars 2024 (grafiku 34).

Tremujorin e parë të vitit 2024, sektori bankar e përmbylli me profit neto prej 43.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të ngadalësuar prej 7.9 përqind nga 29.7 përqind rritje një vit më parë. Profitabiliteti i sektorit u ndikua në masën më të madhe nga rritja e të hyrave, më konkretisht atyre nga interesi në kredi. Rritja e mëtejme e profitabilitetit u neutralizua nga rritja e lartë e shpenzimeve, me theks të veçantë atyre të personelit dhe të përgjithshme, si dhe shpenzimeve të interesit. Gjithsej të hyrat arritën në 116.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 25.2 përqind nga 13.1 përqind një vit më parë. Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 78.0 përqind të gjithë të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, ato në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit dhe njëkohësisht normave të rritura të interesit në kredi në dy vitet e fundit. Për më tepër, edhe të hyrat nga letrat me vlerë kanë shënuar rritje si rezultat i rritjes së investimeve në këtë kategori dhe kthimeve më të larta, përderisa plasmanët me bankat kanë shënuar ngadalësim të theksuar të rritjes në raport me vitin paraprak. Kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje prej 17.0 përqind nga rënia prej 2.6 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 23.4 milionë euro në fund të marsit 2024.


Grafik 34. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 72.8 milionë euro, rritje vjetore prej 38.5 përqind, dukshëm më e theksuar se rritja 2.2 përqind një vit më parë. Kontributin më të lartë e kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, dhe e shpenzimeve të interesit. Kategoria me peshën më të lartë në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 57.6 përqind, u rrit për 29.8 përqind nga 5.8 përqind sa kishte rritje në vitin e kaluar, dhe arritën vlerën prej 42.0 milionë euro në mars 2024. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit. Tutje, shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore prej 51.2 përqind nga rritja prej 51.1 përqind në vitin paraprak, që i atribuohet rritjes së normave të interesit në të gjitha kategoritë që krijojnë shpenzime të interesit dhe njëkohësisht rritjes së stokut të depozitave. Rritja vjetore më e ulët e fitimit të sektorit në raport me rritjen më të lartë të kapitalit, ndikoi që treguesi i Kthimit në Kapital të jetë zbritur lehtësisht në 19.2 përqind nga 21.5 përqind një vit më parë. Ndërsa kthimi në asete zbriti në 2.5 përqind nga 2.6 përqind si rezultat i rritjes më të ngadalësuar vjetore të fitimit krahasuar me rritjen më të lartë të aseteve në këtë periudhë (grafiku 35).


Grafik 35. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Ekspozimet jo-performuese të sektorit bankar janë rritur për 16.6 përqind krahasuar me rritjen prej 5.9 përqind një vit më parë; megjithatë, raporti i kredive jo-performuese qëndroi në nivelin e njëjtë të ulët prej 2.0 përqind, rezultat ky i rritjes së lartë të kreditimit. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlua në 141.4 përqind nga 149.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kjo për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese në raport me vlerën e provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafiku 36).


Grafik 36. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione




Segmenti i ekonomive familjare shënoi rritje të normës së kredive jo-performuese në 1.5 përqind nga 1.3 përqind një vit më parë, ndërsa korporatat jo-financiare mbajtën normën të ngjashme të kredive jo-performuese prej 2.4 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje më të theksuar të ekspozimeve jo-performuese në vlerë prej 7.5 milionë euro apo 33.2 përqind, krahasuar me rritjen e kreditimit për këtë segment prej 17.9 përqind. Për segmentin e korporatave jo-financiare, ekspozimet jo-performuese u rritën për 6.9 milionë euro, apo për 10.6 përqind, kurse gjithsej kreditë për korporatat jo-financiare u rritën 9.5 përqind. Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i prodhimitarisë, energjisë dhe bujqësisë, për 4.1, 3.9 dhe 1.2 milionë euro respektivisht, kurse si raport ndaj kredive është rritur për 0.6, 9.5 dhe 2.1 pikë përqindje, respektivisht. Rrjedhimisht, norma e KJP-ve ka arritur në 2.2 përqind për sektorin e prodhimitarisë, 11.3 përqind për atë të energjisë, dhe 6.8 përqind për bujqësinë. Sektorët si tregtia dhe shërbimet shënuan rënie vjetore të vlerës së KJP-ve për 0.6 dhe 1.6 milionë euro respektivisht, duke rezultuar në normë të kredive-joperformuese prej 1.7 përqind nga 2.0 përqind për sektorin e tregtisë dhe 3.5 përqind nga 4.9 përqind për atë të shërbimeve.

Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, është rritur lehtësisht në 16.1 përqind nga 16.0 përqind në mars të vitit 2023, kurse krahasuar me gjendjen në fund të dhjetorit 2023 është zvogëluar për 0.4 pikë përqindje. Rritja e ulët e normës së kapitalizimit krahasuar me një vit më parë, konkretisht zvogëlimi krahasuar me gjendjen në dhjetor 2023, është kryesisht si rezultat i shpërndarjes së dividendës në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, si dhe normës më të ulët të rritjes së profitit. Rrjedhimisht, Kapitali rregullativ i sektorit në fund të tremujorit të parë shënoi rritje vjetore të ngadalësuar prej 11.9 përqind nga 20.0 përqind rritje një vit më parë. Njëkohësisht, mjetet e peshuara me rrezik kanë shënuar ngadalësim të rritjes në 13.2 përqind nga 15.3 përqind në mars 2023 (grafiku 37), të ndikuar nga ecuria e kreditimit.

Grafik 37. Treguesi i solvencës



Grafik 38. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Raporti i likuiditetit të sektorit shënoi rënie vjetore për 2.4 pikë përqindje, në 31.3 përqind, si rezultat i rritjes më të theksuar të detyrimeve afatshkurtra prej 10.0 përqind në raport me rritjen e mjeteve likuide prej 2.1 përqind (grafiku 38). Gjithashtu, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 3.0 pikë përqindje, në 84.1 përqind. Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) qëndroi lartë mbi minimumin prej 100% të kërkuar me rregullore, përkatësisht në 215.5 përqind në mars 2024, rritje nga 170.6 përqind sa ishte një vit më parë. Mjetet likuide në treguesin e mbulimit me likuiditet dominohen nga mjetet që konsiderohen si më likuide, si paraja e gatshme dhe rezervat me BQK me 28 përqind pjesëmarrje, dhe asetet e qeverive qendrore me 58 përqind.

Përkundër nivelit të lartë të likuiditetit dhe burimit të qëndrueshëm të financimit siç janë depozitat, likuiditetit kërkon monitorim të veçantë, duke marrë parasysh rrethanat e tregut me rritje të konkurrencës dhe kosto më të lartë të financimit, si dhe përshtatjes që akterët e sektorit do të kenë krahas këtyre dinamikave, Si rezultat, pritet që sektori të rritë pjesëmarrjen e financimit nga klientët institucional me implikime potenciale në koncentrim të depozitave/financimit. Njëkohësisht, rritja e koston së financimit mund të nxitë akterët e sektorit për investim në instrumente më pak likuide, por me kthim më të lartë, si kompensim për ngushtimin e marginës së normës së interesit nga disproporcioni i rritjes së normës së interesit në kredi dhe depozita. Veçanërisht është shënuar rritje e investimeve në instrumente financiare të tregjeve të huaja, përderisa investimet në letra me vlerë të qeverisë në vend kanë shënuar përgjithësisht rënie. Struktura e investimeve jashtë vendit në mars 2024 u dominua prej letrave me vlerë me pjesëmarrje 53.2 përqind, e që historikisht dominohej prej depozitave të mbajtura jashtë vendit, të cilat zbritën pjesëmarrjen në 37.8 përqind, krahasuar me 55.4 përqind katër vite më parë.

4.2. Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore të theksuar prej 16.4 përqind deri në mars 2024, nga rritja prej 5.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 39). Ky zhvillim u ndikua nga performanca e mirë në tregjet evropiane dhe në SHBA, si rezultat i optimizimit për frenim të rritjes së mëtejme të normave bazë të interesit nga bankat qendrore dhe zbutja e presioneve inflacioniste. Kthimi nga investimet dhe kontributet e arkëtuara në periudhën janar-mars 2024 shënuan rritje si për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), ashtu edhe për Fondin Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja).

Vlera e aseteve pensionale në mars 2024 arriti në 2.87 miliardë euro, nga të cilat 99.7 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur prej 0.3 përqind nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). FKPK-ja shënoi rritje vjetore të aseteve prej 16.4 përqind, ndërsa asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) u rritën për 12.6 përqind nga viti paraprak.


Asetet e FKPK-së janë të investuara kryesisht në tregun e jashtëm dhe pjesëmarrja e tyre në mars 2024 u rrit për 4.3 pikë përqindje, duke arritur në 79.0 përqind të gjithsej portfolios investuese (grafiku 40). Vlera e këtyre investime, që kryesisht janë portfolio e fondeve të përbashkëta, ka arritur në 2.16 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në tregun e brendshëm. Përdërisa investimet në tregjet e jashtme janë rritur, ato në tregun vendor shënuan rënie vjetore në vlerë prej 114.1 milionë euro, si rezultat i rënies së investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe certifikatave të depozitit.

Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në fund të marsit 2024 zbritën në 497.2 milionë euro nga 549.8 milionë euro sa ishin një vit më parë, apo në 17.4 përqind të gjithsej portfolios investuese nga 22.4 përqind pjesëmarrje një vit më parë. Kategoria e certifikatave të depozitit në bankat vendore zbriti në 90.8 milionë euro nga 128.2 milionë, apo në 3.2 përqind pjesëmarrje të gjithsej investimeve, nga 5.2 përqind sa ishte një vit më parë.


Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK në fund të muajit mars 2024 arriti në 75.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 14.6 përqind nga 18.1 përqind një vit më parë (grafiku 41). Ky zhvillim sugjerohet të jetë rrjedhojë e efektit të bazës më të lartë të kontributeve në vitin e kaluar, të ndikuar nga rritja e pagave të shërbyesve civil në fillim të vitit 2023.

Kthimi bruto në investime arriti në 108.3 milionë euro, duke shënuar një ndër rritjet më të mëdha në këtë periudhë krahasuese ndër vite. Kthimi nga investimet, veçanërisht në muajin mars 2024, u ndikua

Grafik 39. Asetet e sektorit pensional



Grafik 40. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



pozitivisht nga rritja e vlerës së aksioneve në tregjet ndërkombëtare, si rezultat i sinjaleve të politikave monetare për frenim të rritjes tutje të normave bazë të interesit.


Për dallim nga viti i kaluar, përgjatë këtij viti edhe FSKP ka rritur investimet në tregun e jashtëm kundrejt zvogëlimit të investimeve në sektorin e brendshëm (grafiku 40). Kjo ishte si rezultat i zhvillimeve të favorshme në tregjet ndërkombëtare përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024. Portfolio investuese e FSKP-s është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, më konkretisht në aksione që përbëjnë 79.3 përqind të portfolios investuese dhe pjesa tjetër në letra me vlerë, që përbëjnë 3.6 përqind të gjithsej investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, me pjesëmarrje prej 13.4 përqind në gjithsej portfolion investuese. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend, që përbëhet nga paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale, përbëjnë 1.7 përqind të portfolios.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja deri në fund të marsit 2024 arriti në 163.2 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.1 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontributdhënësve dhe njëkohësisht nga rritja e pagave konform indeksimit me inflacion, kryesisht nga sektori privat (grafiku 42). Kthimi kumulativ bruto nga investimet në TM1 2024 arriti vlerën në 518.8 mijë euro, që paraqet dyfishim, përkatësisht rritje vjetore prej 109.8 përqind.

4.3. Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve, me një përfaqësim prej 2.8 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, u karakterizua me rritje, por në nivel më të ngadalësuar se vitet e fundit në këtë periudhë raportuese. Vlera e gjithsej asetëve arriti në 316.0 milionë euro në fund të marsit 2024, rritje vjetore prej 9.0 përqind (grafiku 43). Zgjerimi i sektorit u mundësua nga rritja e rezervave teknike, që janë rezultat i primeve të shkruara përgjatë TM1 2024, si dhe kapitalit vetanak të siguruesve. Në kuadër të asetëve, rritje më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, kryesisht të afatizuara, të cilat burojnë prej të hyrave nga primet e shkruara. Kategoria e dytë për nga pesha,

Grafik 41. Performanca e FSKP-së




Burimi: FSKP.

Grafik 42. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Grafik 43. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.


ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, gjithashtu shënoi rritje të lartë krahasuar me marsin e vitit të kaluar.

Vlera e primeve të shkruara bruto shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 21.7 përqind nga 15.1 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën 41.6 milionë euro. Sigurimet 'Jo-Jetë' shënuan rritje vjetore prej 22.4 përqind në primet e shkruara bruto, ndërsa sigurimet 'Jetë' u rritën për 9.6 përqind në krahasim me tremujorin e parë të vitit paraprak. Rritja vjetore në kuadër të sigurimit 'Jo-Jetë', u ndikua kryesisht nga rritja e primeve të shkruara të kategorisë 'Përgjegjësi motorike ndaj palës së tretë' në kuadër të sigurimit të detyrueshëm, si dhe 'Sigurimi i shëndetit' dhe 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës', në kuadër të sigurimit vullnetar. Kategoria 'Përgjegjësi motorike ndaj palës së tretë' shënoi rritje vjetore prej 10.1 përqind, duke arritur vlerën 19.0 milionë euro prime të shkruara bruto në fund të marsit 2024. Megjithëse, kjo kategori ndër vite ka shënuar trend të rënies në pjesëmarrje të gjithsej primeve të shkruara 'Jo-Jetë', akoma vazhdon të ketë peshën kryesore duke përfaqësuar 49.2 përqind të gjithsej primeve të shkruara 'Jo-Jetë'. Vlera e primeve për 'Sigurimin e shëndetit' arriti në 10.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 31.8 përqind. Kurse, vlera e primeve të arkëtuara për kategorinë 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës' shënoi rritje për 51.4 përqind dhe arriti në 2.9 milionë euro. Vlera e primeve të shkruara në kuadër të sigurimit 'Jetë' arriti në 2.0 milionë euro, ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara për kategorinë 'Jeta e debitorit'. Kjo kategori shënoi rritje prej 20.0 përqind dhe përbënë rreth 50.2 përqind të gjithsej primeve të shkruara në segmentin 'Jetë'.

Numri i policave të sigurimit shënoi rritje vjetore të theksuar prej 47.4 përqind, dhe arriti në 475.5 mijë polica të shitura në tremujorin e parë të vitit 2024. Sektori i sigurimeve 'Jo-Jetë' shënoi rritje më të madhe në numrin e policave të shitura, prej 51.0 përqind. Ndërsa sektori 'Jetë' shënoi rritje prej vetëm 3.9 përqind. Në kuadër të sigurimit 'Jo-Jetë', 'Sigurimi i shëndetit' ka arritur shifrën prej 217.1 mijë polica të shitura apo 123.3 përqind më tepër se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Si rrjedhojë, për herë të parë ka tejkaluar numrin e policave të shitura të llojit 'Përgjegjësi motorike ndaj palës së tretë', numri i të cilave në periudhën janar-mars 2024 arriti në 202.8 mijë sosh, rritje vjetore prej 16.3 përqind.

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në TM1 2024 zbriti në 17.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 10.8 përqind krahasuar me 35.0 përqind rritje në TM1 2023 (grafiku 44). Vlera e dëmeve të paguara vetëm nga kompanitë e sigurimeve shënoi rënie vjetore prej 13.3 përqind, duke zbritur në 15.8 milionë euro në fund të marsit 2024. Kurse vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja arriti në 1.9 milionë euro në fund të muajit mars 2024 nga 1.6 milionë sa ishte një vit me parë, duke shënuar rritje vjetore prej 17.6 përqind. Në rënien e përgjithshme të dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve, kontributin kryesor e kishte kategoria 'Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës', duke u zvogëluar për 92.3 përqind. Ndërsa, kategoria me peshën më të madhe në kuadër të dëmeve të paguara, ajo e 'Përgjegjësisë motorike ndaj palëve të treta', u rrit për 11.9 përqind, kryesisht nga MTPL-të e brendshme.

Grafik 44. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara




Sektori i sigurimeve në TM1 2024 realizoi fitim neto në vlerë prej 3.9 milionë euro nga 2.3 milionë euro një vit më parë. Performanca më e mirë financiare në këtë periudhë është rrjedhojë e rritjes më të lartë të arketimeve nga primet e shkruara në raport me rritjen më të ngadalësuar të dëmeve të ndodhura (jo të paguara). Ndërsa shpenzimet operacionale (që përfshijnë shpenzimet për personelin dhe administrative) shënuan rritje vjetore më të lartë, por për shkak të peshës së ulët në kuadër të shpenzimeve totale, nuk ndikuan në masë të madhe fitimin e sektorit. Zhvillimet pozitive në profit ndikuan që edhe Kthimi në Kapital të jetë më i lartë, përkatësisht në raportin prej 21.1 përqind nga 13.7 përqind një vit më parë. Po ashtu, kthimi në asete u rrit në 6.0 përqind nga 4.2 përqind vitin e kaluar.

Sektori i sigurimeve është duke u rritur dhe zhvilluar gradualisht, megjithatë cilësia e aseteve dhe treguesve kyç mbetet për t'u përmirësuar më tej. Në mars 2024, Kapitali në raport me fondin garantues për siguresit jo-jetë u rritë për 6 pikë përqindje në 159.4 përqind, përderisa për siguresit jetë raporti ishte 146.97 përqind. Kapitali në raport me margjinën minimale të Solvencës për siguresit jo-jetë ishte 151.3 përqind, përderisa për siguresit jetë 1,000 përqind. Mbulueshmëria e provizioneve teknike me asete të pranueshme arriti në 109.2 përqind për siguresit jo-jetë dhe 115.5 përqind për siguresit jetë.

Niveli i likuiditetit të sektorit mbeti i ngjashëm me vitin e kaluar. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 94.8 përqind nga 95.6 përqind në vitin 2023, si rezultat i rritjes vjetore më të ulët të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 9.3 përqind, krahasuar me rritjen më të lartë prej 10.3 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Kurse, raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u rrit në 83.3 përqind nga rritja 82.2 përqind në vitin paraprak.

Grafik 45. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

4.4. Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar shënoi rritje të lartë të aseteve në TM1 2024, kryesisht si rezultat i përsheptimit të rritjes së kreditimit dhe lizingjeve. Vlera e aseteve të sektorit në mars 2024 arriti në 564.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 34.7 përqind (grafiku 45). Kontributin kryesor në këtë rritje e kishte rritja e kreditimit dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe rritje ka shënuar edhe bilanci me bankat komerciale, që janë kryesisht të mbajtura në llogari rrjedhëse. Burimi kryesorë i financimit të rritjes së aktivitetit të sektorit mbeten huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit, të cilat u rritën për 34.3 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, nga fitimi i bartur ndër vite dhe atij të realizuar gjatë kësaj periudhe.


Grafik 46. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.


Kreditë e sektorit në tremujorin e parë të vitit u rritën me ritëm të përshpejtuar, duke arritur vlerën 377.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.0 përqind (22.4 përqind rritje në vitin paraprak). Të dy segmentet, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare, u karakterizuan me rritje. Vlera e kredive për ekonomi familjare në TM1 2024 arriti në 227.6 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 18.5 përqind (grafiku 46). Kreditimi ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën 149.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 33.5 përqind, të ndikuar nga rritja në të gjithë sektorët ekonomik (grafiku 47).

Grafik 47. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 48. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Vlera e kredive ndaj sektorit të bujqësisë në mars 2024 arriti në 37.3 milionë euro, rritje vjetore prej 30.3 përqind. Për dallim nga sektori bankar ku kreditë për bujqësi kanë pjesëmarrje të ulët, në sektorin mikrofinanciar kreditë për bujqësinë kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë ndaj KJF-ve, përkatësisht 25.0 përqind pjesëmarrje në mars 2024. Rrjedhimisht, rritja e lartë në kreditë e bujqësisë, e mundësuar gjithashtu nga mbështetja e vazhdueshme nga garancionet e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, dhe kontributin kryesorë në rritjen e gjithsej kreditimit të KJF-ve nga mikrofinancat (grafiku 48).

Lizingjet, me një pjesëmarrje prej 17.2 përqind në strukturën e aseteve të sektorit, shënuan po ashtu rritje të përshpejtuar. Vlera e tyre arriti në 97.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 30.2 përqind nga 12.0 përqind një vit më parë (grafiku 49). Kontributin kryesor në rritjen e lizingjeve vazhdojnë ta kenë korporatat jofinanciare, të cilat kanë dhe peshën më të lartë prej 70.1 përqind në gjithsej lizingjet, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i ulët.

Grafik 49. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga mikrofinancat në TM1 2024


ishte 19.0 përqind, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.4 pikë përqindje. Rënie kishte në normën e interesit për ekonomitë familjare, ndërsa kreditë për korporata jo-financiare u karakterizuan me rritje. Norma mesatare e interesit për kreditë e ekonomive familjare zbriti në 21.3 përqind nga 21.8 përqind. Në kuadër të kredive që shënuan rënie të normës së interesit ishin kreditë hipotekare, nga 19.5 përqind në 17.4 përqind, ndërsa kreditë konsumuese shënuan rritje për 0.6 pikë përqindje duke arritur në 23.7 përqind (grafiku 50). Për korporatat jo-financiare, norma mesatare e interesit arriti në 16.2 përqind, duke shënuar rritje për 0.3 pikë përqindje (grafiku 51). Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve shënoi rritje për 0.6 dhe 0.9 pikë përqindje, duke arritur në 18.3 dhe 15.4 përqind, respektivisht.

Ndërsa, norma e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë shënoi rënie për 0.2 pikë përqindje nga një vit më parë, duke zbritur në 17.8 përqind në mars 2024.

Grafik 50. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Grafik 51. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarje, sipas sektorëve ekonomik




Profiti neto i sektorit në tremujorin e parë të vitit shënoi rritje vjetore të përsheptuar prej 20.0 përqind (0.9 përqind rritje në vitin paraprak), duke arritur vlerën prej 4.9 milionë euro. Të hyrat e sektorit arritën vlerën 20.6 milionë euro, rritje vjetore prej 35.2 përqind. Shpenzimet u rritën për 40.9 përqind, duke arritur kështu vlerën 15.6 milionë (grafiku 52). Të hyrat nga interesi shënuan rritje të përsheptuar vjetore prej 24.6 përqind nga 16.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit. Vlera e tyre në mars 2014 arriti në 17.3 milionë euro, duke përfaqësuar 84.4 përqind të gjithë të hyrave. Të ardhurat nga jo-interesi arritën vlerën në 3.2 milionë euro, për 1.9 milionë euro më e lartë se një vit më parë (shprehur në përqindje, për 150.5 përqind më e lartë). Kjo rritje e theksuar e të hyrave nga jo-interesi është kryesisht si rrjedhojë e riklasifikimit të dy institucioneve financiare me peshë të konsiderueshme në kuadër të gjithë asetëve të sistemit, të cilat në të kaluarën trajtoheshin si ndihmës financiar, kurse tani janë rikategorizuar në kuadër të IMF/IFJB-ve, që për aktivitet kryesorë kanë shërbimet e pagesave. Andaj, kjo ka rezultuar në rritje të theksuar të nënkategorisë së të ardhurave nga jointerеси, pa afektuar të ardhurat nga interesi (pasi që këto institucione nuk lëshojnë kredi).

Grafik 52. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Grafik 53. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Në kuadër të shpenzimeve, rritje të theksuar ka shënuar kategoria e shpenzimeve nga interesi, duke arritur vlerën 5.1 milionë euro apo rritje vjetore prej 95.4 përqind nga 35.2 përqind rritje një vit më parë. Rritja e nivelit dhe koston e huazimit nga jashtë është reflektuar në këtë rritje të theksuar të shpenzimeve nga interesi,

meqenëse aktiviteti i sektorit mikrofinanciar e financon veprimtarinë në masën më të madhe nga këto huazime/linja kreditore (60.6 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit vetanak). Po ashtu, rritje ka shënuar edhe kategoria e shpenzimeve nga jointeresi e cila arriti në 8.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 22.4 përqind. Rritja e kësaj kategorie është kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve të personelit dhe administrative për 18.3 përqind, duke arritur vlerën 7.3 milionë euro.

Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive shënoi rënie vjetore në 1.7 përqind nga 1.8 përqind në mars 2023, përkundër rritjes së lehtë të vlerës së kredive joperformuese. Vlera e kredive joperformuese ka arritur në 7.7 milionë euro nga 6.8 milionë në vitin paraprak, mirëpo për shkak të rritjes së lartë të kreditimit raporti i kredive joperformuese ka shënuar rënie. Niveli i mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione në mars 2024 u rrit për 4.7 pikë përqindje, në 154.5 përqind (grafiku 53). Niveli i kredive jo-performuese vazhdon të jetë më i lartë për IFJB-të kundrejt IMF-ve, por që gradualisht është zvogëluar ndër vite (grafiku 54).

Grafik 54. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.



Burimi: BQK.


4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) është zvogëluar në 8.96 përqind në fund të tremujorit të parë të vitit 2024 nga 11.28 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Letrat me vlerë të emetuara gjatë kësaj kishin shumën prej 50.5 milionë euro, që është për 2.6 përqind më e ulët sesa emetimi në tremujorin e parë të vitit 2023 (grafiku 55).

Kërkesa e akterëve në treg për të investuar në letra me vlerë, në nivele marginale ka tejkaluar ofertën e qeverisë, për 1.001 herë, përdërisa ky raport një vit më parë ishte 1.23 (grafiku 56). Kjo rënie e raportit kërkesë/ofertë kryesisht reflekton zhvillimet në sektorin bankar dhe atë pensional, të cilat kanë rialokuar investimet në letrat me vlerë drejt sektorit të jashtëm.

Mbajtësit e letrave me vlerë qeveritare udhëhiqen nga fondet pensionale që përbëjnë 46 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 24 përqind, institucionet publike 22 përqind dhe kompanitë e sigurimit që përbëjnë 5 përqind të stokut të borxhit dhe pjesa e mbetur prej 3 përqind mbahen nga të tjerë investitor.

Grafik 55. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Në fund të marsit 2024, stoku i borxhit të brendshëm të qeverisë së Kosovës në formë të letrave me vlerë, të mbajtur nga investuesit si bankat, fondet pensionale, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimit kishte vlerën prej 945.0 milionë euro nga 1.11 miliard euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit ndër vite ka pësuar ndryshime graduale, duke u zgjeruar drejt afateve më të


gjata të maturimit. Në periudhën janar-mars 2024, struktura u dominua nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitetet prej ‘365 ditësh’, që përbëjnë rreth 39.6 përqind të emetimeve të reja, pasuar nga ato me maturitetet prej ‘3 vite’ dhe ‘5 vite’, (grafiku 57).

Grafik 56. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 57. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 46, TM1 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostonë së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu); Key ECB interest rates (europa.eu)

FAO: [Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations \(fao.org\)](http://fao.org)

IMF (FMN): [International Monetary Fund \(IMF\)](http://imf.org)

World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](http://www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org